

Vendim nr. 254 datë 01.11.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji, Kryesuese
Sandër Beci, Anëtar
Ilir Toska, Anëtar

në datën 01.11.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 7 (B) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: BAJAZIT REÇI

OBJEKTI: Shfuqizimi i pikës 3, shkronja “a”, të udhëzimit nr. 33, datë 20.12.2023 të ministrit të Financave “Për mënyrën e zbatimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 161, datë 21.03.2018 “Për pagesën e së ardhurës nga papunësia”, të ndryshuar”.

BAZA LIGJORE: Nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 20.12.2023 ministri i Ekonomisë dhe Financave ka miratuar udhëzimin nr. 33, datë 20.12.2023 “Për mënyrën e zbatimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 161, datë

21.03.2018 “Për pagesën e së ardhurës nga papunësia”, të ndryshuar” (*udhëzimi nr. 33/2023*), i cili është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 191, datë 28.12.2023.

2. Në pikën 3, shkronja “a”, të udhëzimit nr. 33/2023 të ministrit të Financave dhe Ekonomisë parashikohet se kategoritë përfituese të pagesës së të ardhurës nga papunësia janë të gjithë personat të cilët kanë kontribuar si punëmarrës në sigurimet shoqërore për një periudhë të paktën 12 muajore gjithsej brenda 24 muajve të fundit, me kusht që dy muajt e fundit të jenë pa ndërprerje, për çdo rast përfitimi.

3. Ndërkohë në nenin 53, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 7703/1993*) parashikohet se personat e siguruar përfitojnë të ardhura papunësie, në rast se kanë kontribuar në sigurimin shoqëror jo më pak se 12 muaj për çdo rast përfitimi. Po kështu, pika 2 e vendimit nr. 161, datë 21.03.2018 të Këshillit të Ministrave “Për pagesën e të ardhurave nga papunësia” (*VKM nr.161/2018*) përcakton se përfitojnë të ardhura nga papunësia të gjithë personat e siguruar që plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 53 të ligjit nr. 7703/1993.

4. Shtetasi Bajazit Reçi (*kërkuesi*) ka punuar me periudha të shkëputura kohore nga viti 1981 deri në vitin 2024 dhe nuk ka përfituar asnjëherë pagesë papunësie. Periudha e fundit e punësimit të tij (në sektorin privat) ka qenë nga data 01.04.2024 deri në datën 23.05.2024, në vijim të së cilës kërkuesi ka përgatitur dokumentacionin përkatës për përfitim të pagesës së papunësisë, por i është komunikuar se nuk mund ta përfitojë atë si pasojë e parashikimit të udhëzimit nr. 33/2023 të ministrit të Financës dhe Ekonomisë.

5. Në datën 26.07.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar me dokumentet e kërkuara, bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 12.08.2024.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se pika 3, shkronja “a”, e udhëzimit nr. 33/2023 të ministrit të Financave dhe Ekonomisë cenon të drejtën e përfitimit të të ardhurave nga papunësia, të parashikuar në nenin 53, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr.

7703/1993 dhe VMK-në nr. 161/2018, sipas të cilave personat e siguruar përfitojnë të ardhura papunësie në rast se kanë kontribuar në sigurimin shoqëror jo më pak se 12 muaj për çdo rast përfitimi. Togfjalëshi “*brenda 24 muajve*” i shtuar në udhëzimin nr. 33/2023 të ministrit të Financave dhe Ekonomisë del qartë mbi ligjin nr. 7703/1993 dhe VKM-në nr. 161/2018. Ky udhëzim nuk mund të cenojë të drejtën e përfitimit të të ardhurave nga papunësia që japin ligji dhe VKM-ja.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual në çdo rast duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Gjykata ka pohuar se bazuar në nenet 49, pika 3, shkronja “e” dhe 71, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, objekti i ankimit kushtetues individual, krahas vendimit gjyqësor, mund të jetë edhe ligji ose akti normativ. Në këto raste, nisur nga përmbajtja e normave kushtetuese dhe atyre ligjore, kërkuari legjitimohet nëse plotësohen bashkërisht këto kriterë: (i) legjitimimi *ratione personae*, në kuptimin që individi provon se është bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar, si dhe provon interesin në lidhje me çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese; (ii) shterimi i mjeteve juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar ose individi provon se akti i kundërshtuar është drejtpërdrejt i zbatueshëm; (iii) legjitimimi *ratione temporis*, në kuptimin që individi ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit; (iv) legjitimimi *ratione materiae*, në kuptimin që individi provon se pretendimet e ngritura janë të tilla që bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, pra të drejtat dhe

liritë themelore, që pretendohen se janë cenuar, janë të garantuara në Kushtetutë, si dhe shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur (*shih vendimet nr. 34, datë 12.06.2023; nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Për sa i takon legjitimitimit *ratione personae*, fillimisht evidentohet se parashikimet e ligjeve dhe të akteve të nxjerra në zbatim të tyre, si rregull, kanë natyrë abstrakte dhe të përgjithshme, për rrjedhojë legjitimitimi i individit për kundërshtimin e tyre në Gjykatë lidhet me cenimin e drejtpërdrejtë që individi pëson në të drejtat kushtetuese të tij nga akti i kundërshtuar. Pra, akti i kundërshtuar duhet t'i sjellë efektet ndaj individit drejtpërdrejt, pasi zbatimi i tij nuk lidhet me akte të mëtejshme nënligjore. E thënë ndryshe, zbatimi i aktit të kundërshtuar duhet të jetë i menjëhershëm dhe pa pasur nevojën e ndërhyrjes së ndërmjetme të rregullave ose autoriteteve të tjera publike. Në këtë mënyrë, ky kriter legjitimitimi kërkon që individi të provojë dy elemente: (i) akti me zbatimin e tij i ndryshon drejtpërdrejt situatën juridike kërkuesit, duke i mohuar ose zvogëluar të drejtat; (ii) rregullat e aktit janë automatikisht të zbatueshme dhe nuk lënë diskrecion për organet e pushtetit publik, në mënyrë që këto të fundit të veprojnë ndaj individit me anë të akteve të mëtejshme.

10. Në rastin objekt shqyrtimi, Kolegji konstaton se kërkuesi ka kërkuar shfuqizimin e pikës 3, shkronja "a", të udhëzimit nr. 33/2023 të ministrit të Financës dhe Ekonomisë, ku përcaktohen kategoritë përfituese të pagesës së të ardhurës nga papunësia dhe specifikisht kategorisë që përfshin ata persona, të cilët kanë kontribuar si punëmarrës në sigurimet shoqërore për një periudhë të paktën 12 muajore, gjithsej brenda 24 muajve të fundit, me kusht që dy muajt e fundit të jenë pa ndërprerje për çdo rast përfitimi. Ai ka pretenduar se parashikimi i mësipërm është në kundërshtim me nenin 53 të ligjit nr. 7703/1993 dhe VKM-në nr. 161/2018, si dhe ka cenuar të drejtën e tij të përfitimit të të ardhurës nga papunësia.

11. Për sa më lart, Kolegji vëren se udhëzimi nr. 33/2023 i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nuk është një akt drejtpërdrejt i zbatueshëm, pasi në bazë të VKM-së nr. 161/2018 dhe udhëzimit nr. 33/2023 të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, përfitimi i të ardhurës nga papunësia kushtëzohet me paraqitjen e kërkesës dhe dokumentacionit përkatës pranë strukturës vendore përkatëse brenda 60 ditëve kalendarike nga data e shkëputjes së marrëdhënieve të punësimit me punëdhënësin. Në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka parashtruar se ka përgatitur dokumentacionin për përfitimin e kësaj pagese, por i është komunikuar se nuk përfiton të ardhura nga papunësia si pasojë e parashikimit të udhëzimit nr. 33/2023.

12. Kolegji konstaton se kërkuesi nuk e ka provuar refuzimin nga ana e organit kompetent të kërkesës së tij si pasojë e parashikimit të aktit të kundërshtuar përmes një akti administrativ individual, i cili në çdo rast duhet të ishte bërë fillimisht objekt shqyrtimi në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Në këto rrethana, Kolegji vlerëson se për kërkimin lidhur me shfuqizimin e pikës, 3, shkronja “a”, të udhëzimit nr. 33/2023 të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae*, pasi nuk provohet që ai mund nuk t’i ketë shkaktuar cenim të drejtpërdrejtë dhe real në të drejtat e tij kushtetuese.

13. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjën “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.